

D E K R E T
Nr.7466, datë 31.1.1991

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.6600, DATË 30.6.1982 "PËR INSTITUTIN E
ARKAVE TË KURSIMIT DHE TË SIGURIMEVE"**

Neni 1

Në ligjin nr.6600, datë 30.6.1982 "Për Institutin e Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve", në nenin 4 shtohet paragrafi i katërt me këtë përmbajtje:

"Rregullat, kushtet dhe afatet për depozitat e kursimit caktohen nga Instituti i Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve".

Neni 2

Pas nenit 14 shtohet neni 14/a me këtë përmbajtje:

"Instituti i Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve, në bazë të dispozitave të Këshillit të Ministrave, bën sigurimin e investimeve që kryhen në Republikën e Shqipërisë nga ndërmarrjet, firmat, personat fizikë të huaj a shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dhe të pasurive që lidhen me to, si dhe sigurimin e pasurisë së ndërmarrjeve me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj, të cilat ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Neni 15 ndryshohet si vijon:

"Instituti i Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve bën risigurime në bazë të dispozitave të Këshillit të Ministrave".

Neni 4

Pas nenit 15 shtohet neni 15/a me këtë përmbajtje:

"Instituti i Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve ka të drejtë të lidhë marrëveshje për sigurime dhe risigurime me shoqëri, institucione dhe organizata të shteteve të tjera".

Neni 5

Neni 17 ndryshohet si vijon:

"Instituti i Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve ka këto fonde"

- a) fondi themeltar;
- b) fondi rezervë në lekë;
- c) fondi rezervë në valutë.

Fondet rezervë caktohen me dispozita të Këshillit të Ministrave dhe përdoren nga Instituti i Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve"

Neni 6

Titulli i nenit 14 emërtohet "Sigurime dhe Risigurimet", titulli i nenit 15 hiqet dhe në titullin e nenit 16 hiqen fjalët "...të Institutit të Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve".

Neni 7

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.